
MANAGEMENT PLANNING AND FUNCTIONING IN SMALL AND MEDIUM ENTERPRISES IN KOSOVO

Violeta Koleci

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, violeta.koleci@hotmail.com

Redon Koleci

“Vasil Levski” National Military University, Veliko Tarnovo Bulgaria redon_koleci@hotmail.com

Abstract: Planning as a managerial function implies the important process of predicting the future. In business planning plays a key role, as it depends on the fate of the enterprise in some way. It is also known that planning is unavoidable in all areas, as well as planning as the first and basic stage of forecasting reduces the uncertainty and uncertainty of either the enterprise or beyond. Looking at planning as a process of predicting the future takes into account the very important role of the manager in wanting to reduce the mistakes in making a decision, he must foresee all possible factors to come up with. to achieve the goal. Thus the goal is the first step of planning, as all plans must contribute to the achievement of the goals. All entrepreneurs need to know exactly where they are right now and where they want to go when making plans, because they need to know what the critical path is or what paths to follow. So, given the nature of this paper, among other things, I have tried to present the overall goals, but also of the business organization in particular, the hierarchy of these goals, the process of setting and the stages to follow until reaching the goals. Also the models used in planning, and who prepares the plans, what they mean and who deals with them. I have also tried to describe in detail the necessary techniques and models that are an inevitable part of sustainable planning.

Planning is a placement system, where based on anticipating possible situations in the surroundings, it is required that combination of available and expected resources be used to enable the rapid growth of the business organization. - Planning is the adaptation of business activities to changes whereby it can escape all risks and efficiently exploit the opportunities given.

Planning as a process or mental activity represents the thinking process, organized mission prediction, based on facts and experience, which are necessary to undertake any conscious activity. Planning is an intellectual process, a mental disposition to do things properly, to think before acting, to act in the light of facts rather than intentionally.

Keywords: Planning, managing, making decisions and achieving goals.

PLANIFIKIMI DHE FUNKSIONI I MENAXHMENTIT NË NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME NË KOSOVË

Violeta Koleci

Kolegji “BIZNESI” Prishtinë, Kosovë, violeta.koleci@hotmail.com

Redon Koleci

“Vasil Levski” National Military University, Veliko Tarnovo Bulgaria redon_koleci@hotmail.com

Abstrakt: Planifikimi si funksion menaxherial nënkupton procesin e rëndësishëm të parashikimit të ardhmërisë. Në biznesbërje planifikimi luan rolin kyç, pasi që nga ai varet fati i ndërmarrjes në njëfarë mënyre. Poashtu dihet se planifikimi është i pashmangshëm në të gjitha lëmit, gjithashtu planifikimi si faza e parë dhe bazë e parashikimit zvogëlon pasigurinë dhe paqartësinë qoftë të ndërmarrjes apo më gjërë. Duke e parë planifikimin si një proces që ka të bëjë me parashikimin e ardhmërisë vie në konsideratë roli shumë i rëndësishëm i menaxherit që duke dashur të zvogëlohen gabimet në marrjen e ndonjë vendimi, ai duhet të parashikoj të gjithë faktorët e mundshëm, për të ardhur deri te realizimi i qëllimit. Kështu qëllimi është hapi i parë i planifikimit, ngase të gjitha planet doemos duhet të kontribuojnë në realizimin e qëllimeve. Të gjithë ndërmarrësit gjatë bërjes së planeve duhet ta dinë saktë se ku janë momentalisht dhe se ku duan të arrijnë, për arsye se duhet ta dinë se cila është rruga kritike apo se cilat rrugë duhet t'i ndjekin. Ndaj duke e pasur parasysh natyrën e këtij punimi veç tjerash, jam munduar të paraqes qëllimet e përgjithshme, por edhe të organizatës afariste në veçanti, hierarkinë e këtyre qëllimeve, procesin e vendosjes dhe fazat që duhet ndjekur ky proces deri tek arritja e qëllimeve. Poashtu modelet që perdoren gjatë bërjes së planifikimit, dhe se kush i përgatit planet, çfarë rëndësie kanë këto plane dhe se kush merret me realizimin e tyre etj. Gjithashtu jam munduar t'i përshkruaj në mënyrë të detajuar edhe teknikat dhe modelet e domosdoshme që janë pjesë e pashmangshme e planifikimit të qëndrueshëm.

Planifikimi përkufizohet si një proces që përfshin një spektër të gjërë të fazave të radhitura në këtë mënyrë: formulimi i qëllimeve dhe i misionit, objektivat, strategjitë, politikat, procedurat, rregullat, programet dhe buxhetet për arritjen e tyre, ku si rezultat i këtij procesi janë planet.

Planifikimi është sistem i vendosjes, ku në bazë të parashikimit të situatave të mundshme në rrethinë, kërkohet ai kombinim i resurseve të disponuara dhe të pritura, me të cilat mund të realizohet rritja e shpejtë e organizates së biznesit. - Planifikimi është përshtatja e aktiviteteve afariste ndaj ndryshimeve me ç'rast mund t'iu ikë të gjitha rreziqeve dhe në mënyrë efikase t'i shfrytëzojë mundësitë e dhëna.

Planifikimi si proces apo aktivitet mental paraqet procesin e të menduarit, parashikimin e organizuar të misionit, bazuar në fakte dhe përvojë, të cilat janë të nevojshme për të ndërmarrë ndonjë aktivitet të vetëdijshëm. Planifikimi paraqet proces intelektual, paradispozitë mentale për t'i bërë gjërat ashtu si duhet, për të menduar para se të veprojë, të veprojë në dritën e fakteve e jo me të qëlluar.

Fjalët kyçe: Planifikimi, menaxhimi, marrja e vendime dhe realizimi i qëllimeve.

1. HYRJE

Të gjitha ndërmarrjet, të vogla apo të mëdha, private apo publike, në Kosovë të orientura nga fitimi ose jo e pavarësisht nga fusha ku e ushtrojnë aktivitetin e tyre kanë një gjë të përbashkët: nevojën për t'u menaxhuar. Menaxherët janë burimi kryesor, më i kushtueshmi dhe më i rëndësishmi për çdo organizatë. Praktika ka vërtetuar se në mjaftë raste në suksesin apo dështimin e biznesit faktori vendimtar ka qënë aftësia e ekipit menaxherial. Planifikimi paraqet procesin e përcaktimit të fatit të kompanisë që ajo të eci rrugës të cilën e dëshiron, përkatisisht të arrijë qëllimin e caktuar. Secila organizatë për të arritur qëllimet e saj fillimisht duhet të bëjë planifikimin e duhur. Planifimi shihet të jetë shtylla kryesore e çdo organizate drejtë arritjes së qëllimeve dhe se kjo në praktikë shihet të jetë mjaftë e veshtirë e posaqërisht e ndermarrësve të rinj. Maxhimi në vendin tonë shihet se ka mangësi gjithashtu edhe planifikimi në të shumtën e rasteve nuk është ai i cili duhet të jetë. Ndaj menaxhimi dhe planifikimi shihen të jenë si problematike në vendin tonë dhe kjo i kushton organizatës shumë shtrenjtë, në shumicën e rasteve edhe me falimentim.

2. PLANIFIKIMI SI FUNKSION I MENAXHMENTIT

Planifikimi është funksion i menaxhmentit me të cilin zgjedhet drejtimi efikas i aksioneve me qëllim të sigurimit, shfrytëzimit, vendosjes apo zëvendësimit të resurseve në organizatë. Planifikimi paraqet procesin e përcaktimit të fatit të kompanisë që ajo të eci rrugës të cilën e dëshiron, përkatësisht të arrijë qëllimin e caktuar.

Planifikimi është njëri ndër funksionet më të rëndësishme të Menaxhmentit, bashkë me organizimin, udhëheqjen, drejtimin e kontrollin. Ndaj si funksion i Menaxhmentit me plot të drejtë mund të thuhet se planifikimi është faza e parë dhe më e rëndësishme e menaxhmentit dhe baza e të gjitha fazave tjera të Menaxhmentit. Nëse e shikojmë historikisht planifikimin vijmë në përfundim se planifikimi është i vjetër sa edhe vetë njeriu.

Planifikimi përfshin përcaktimin e qëllimeve të organizatës, krijimin e një strategjie të përgjithshme dhe zhvillimin e një skeme gjithëpërfshirëse të planeve për të integruar dhe koordinuar punën organizative.

Planifikimi joformal - asgjë nuk është e shkruar.

Planifikimi formal - i shkruar

Modeli themelor i planifikimit ka pesë faza:

1. Definimi i qëllimeve të organizatave.
2. Përcaktimi i të gjitha rrugëve të mundshme për tu arritur qëllimet e definuara.
3. Zgjedhja e alternativës më të mirë për realizimin e qëllimit.
4. Zhvillimi i alternativës së zgjedhur.
5. Aktivizimi i planeve.³⁰

3. PROCESI DHE PËRMBAJTJA E PLANIFIKIMIT

Njeriu, si qenie e vetëdijshme, para se të fillojë ndonjë aktivitet, duhet t'ia caktojë vetes një qëllim se ku dëshiron të arrijë. Me të përcaktuar qëllimin, ai duhet të mendojë edhe se në ç'mënyrë do ta arrijë, me ç'mjete, në çfarë afati kohor, me ndihmën e kujt, e kështu me radhë. Kjo mënyrë e të menduarit të njeriut në fakt paraqet planifikimin, si pjesë përbërëse e çdo veprimtarie të tij të vetëdijshme. Pra, nga kjo rrjedh se planifikimi është një aktivitet (proces), në të cilin përfshihet vendosja e qëllimit dhe mënyra e realizimit të tyre. Lidhur me përkufizimin e planifikimit ekzistojnë qasje të ndryshme:

Planifikimi paraqet procesin e përcaktimit të aktiviteteve, lidhur me pyetjet: çka?, si, kush dhe kur, para se të ndërmerren aksione menaxheriale.

³⁰ Ramosaj, B, "Management, Bazat e menaxhimit", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2007.

Planifikimi përkufizohet si një proces që përfshin një spektër të gjërë të fazave të radhitura në këtë mënyrë: formulimi i qëllimeve dhe i misionit, objektivat, strategjitë, politikat, procedurat, rregullat, programet dhe buxhetet për arritjen e tyre, ku si rezultat i këtij procesi janë planet.

Planifikimi është sistem i vendosjes, ku në bazë të parashikimit të situatave të mundshme në rrethinë, kërkohet ai kombinim i resurseve të disponuara dhe të pritura, me të cilat mund të realizohet rritja e shpejtë e organizates së biznesit. - Planifikimi është përshtatja e aktiviteteve afariste ndaj ndryshimeve me ç'rast mund t'iu ikë të gjitha rreziqeve dhe në mënyrë efikase t'i shfrytëzojë mundësitë e dhëna.

Planifikimi si proces apo aktivitet mental paraqet procesin e të menduarit, parashikimin e organizuar të misionit, bazuar në fakte dhe përvojë, të cilat janë të nevojshme për të ndërmarrë ndonjë aktivitet të vetëdijshëm. Planifikimi paraqet proces intelektual, paradispozitë mentale për t'i bërë gjërat ashtu si duhet, për të menduar para se të veprojë, të veprojë në dritën e fakteve e jo me të qëlluar.

Planifikimi është funksion i menaxhmentit, në të cilin zgjidhet drejtimi efikas i aksioneve, me qëllim të sigurimit, shfrytëzimit, vendosjes apo zëvendësimit të resurseve të organizatës.

Planifikimi përkufizohet si aktivitet mental ose si proces i gjykimit, i parashikimit të organizuar të së ardhmes, bazuar në faktet dhe përvojat që janë të nevojshme për aksione të mençura.

Planifikimi është pjesa thelbësore përbërëse e procesit të vendimmarrjes dhe administrimit në afarizëm, e kjo do të thotë se administrimi në subjektet ekonomike fillon pikërisht me këtë funksion, ngase planifikimi është një proces që mundëson realizimin e të gjitha funksioneve të tjera.³¹

Planifikimi është detyra më e rëndësishme e menaxhmentit, e në mënyrë që të jetë efikas, është e domosdoshme që menaxhmenti ta njehë procedurën përkatësisht procesin dhe përmajtjen e planifikimit.

Menaxherët gjatë procesit të planifikimit duhet të kenë parasysh eficientë për shkak se nga ata kërkohen në anën tjetër rezultate, dhe kosto optimale.

Prandaj hapi i parë i planifikimit është përcaktimi i qëllimit, sepse të gjitha planet duhet të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve. Për menaxherin është e nevojshme të shoh të ardhmen si zhvillim. Menaxheri duhet të definon objektivat(qëllimet) e organizatës dhe krijimin e një strategjie të përgjithshme për arritjen e këtyre qëllimeve Për të është thelbësore arritja e qëllimit, prandaj atë zhvillim ai duhet ta shoh nga pikëpamja e orientimit të zhvillimit dhe të rezultatit. Qëllimet e organizatës janë synime ku ajo dëshiron të arrijë në të ardhmen dhe kahë e cila janë të orientuara aktivitetet e planifikuara. Nëse i shqyrtojmë qëllimet e organizatës afariste vijmë në përfundim se ajo ka disa qëllime si:

Rritja më e shpejtë e të ardhurave, Fitimi, Ekzistenca, Pozita e favorshme në treg, Zgjerimi i mundësive për rritje etj. Fokusi i menaxherëve.

Eficienca - Bërja e punëve në mënyrë të duhur, pra realizimi i sa më shumë autputeve me sa më pak inpute.

Efektiviteti - Bërja e punëve të duhura, pra arritja e synimeve të organizatës.

Disa kompani mund të jenë shumë eficiente mirëpo të jenë in-efektive, ndërsa disa të tjera janë efektive mirëpo paralelisht in-eficiente.³²

4. PREMISAT

Premisat janë hipoteza mbi ngjarjet e së ardhmes të cilat mund të ndikojnë në veprimtarinë e organizatës. Karakteristikë e përbashkët e të gjitha premisave pa marrë parasysh llojin, është se ato krijohen qoftë si parasupozime mbi lëvizjen globale, qoftë të intuites apo përvojës, si dhe mbështeten në analiza sasiore. Në esencë të gjitha së bashku pasqyrojnë vlerësimin mbi ndodhitë e mundshme.

Marrë në tërësi planifikimi nënkupton procesin e nevojshëm të parashikimit të asaj që do të ndodhë në të ardhmen e afërt apo të largët. Ndaj kur themi se planifikimi nënkupton procesin e parashikimit për të ardhmen, njëkohsisht kuptojmë se parashikimi mbështetet në zvogëlimin e pasigurisë dhe paqartësisë qoftë të ndërmarrjes apo më gjërë. Shpesh na bie të parashikojmë ngjarje që do të ndodhin si bie fjala si do të jete koha, apo të parashikojmë një ndeshje sportive apo edhe kur japim premisat si parasupozime se kush do t'i fitoj zgjedhjet, cila parti do të vie në pushtet në mandatin e ardhshëm etj.

Natyra e parashikimit shpesh na bën të fitojmë edhe përvoja të hidhura, mirëpo pa marrë parasysh ne duhet patjetër të parashikojmë, me çka nëpërmes kësaj kuptojmë edhe arsyeshmërinë e parashikimit e cila qëndron në atë se pa ndonjë vlerësim të së ardhmes, nuk ka as plane. Me qëllim që e ardhmja të shihet si rruga më e favorshme, me të cilën arrihet qëllimi, udhëheqësi duhet të shoh në të pasojat e parashikimeve të veta. Prandaj për të është shumë e

³¹ Robo. M dhe Xhavarra. A, “Bazat e Sipërmarrjes”, Shtëpia botuese e librit Universitar, Tiranë, 2012

[1]. ³² Papa M. Daniels J. Spiker B. “Organizational Communication”, Sage, Losangelos USA, 2008.

rëndësishme të analizoj të dhënat nga e kaluara, sepse e ardhmja është vazhdim i së kaluarës, ndërsa e tashmja është kufi mes tyre.³³

5. METODAT E PARASHIKIMIT

Parashikimi si pjesë e planifikimit paraqet procedimin e nevojshëm për të matur pasigurinë që sjellë ardhmëria. Qëllimi i parashikimit është të zvogëlojë gjasat për gabime, si dhe të shtojë njohuritë për të ardhmen.

Ekzistojnë katër metoda të parashikimit:

- 1) Ekstrapolacioni i trendit.
- 2) Analiza ekonomike.
- 3) Hulumtimi i tregut.
- 4) Mendimet e eksperteve.

Ekstrapolacioni i trendit - paraqet projektimin e thjeshtë të tendencave nga e kaluara në të ardhmen. Per shkak të thjeshtësisë dhe dobësive të tjera që paraqiten në metoden e trendit gjatë parashikimit, paraqitet nevoja e kombinimit të kësaj metode me metoda tjera të parashikimit.

Analiza ekonomike - paraqet metoden mjaft komplekse të parashikimit të ardhmës. Me ndihmën e kësaj metode menaxherët hartojnë llogari të ndryshme statistikore të aktiviteteve industriale me qëllim që të vlerësojnë segmentet e caktuara të ekonomisë që paraqesin parasupozimet elementare të trendeve afariste.

Hulumtimet e tregut - paraqesin metoden e mbledhjes dhe analizës së të dhënave mbi kërkesat blerëse të konsumatorëve. Kjo metodë mbështetet në hulumtimin e përgjigjeve në pyetjet sa do të prodhohet? Si do të prodhohet? dhe çfarë do të blihet?

Për të parashikuar të ardhmen janë të nevojshme edhe të dhënat cilësore e këto të dhëna që kanë karakter të përcaktimit të faktorëve të përveçshëm përkatësisht në formë të mendimit të individëve dhe grupeve profesionale luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e parashikimeve mbi të ardhmën.

Ekzistojnë disa parime me rastin e zgjedhjes së metodes, e këto janë:³⁴

- Definimi i gjerësisë së parashikimit,
- Efektiviteti i parashikimit dhe
- Thjeshtëzimi i parashikimit.

6. PËRFUNDIM

Menaxherët luajnë një rol kyç në çdo organizatë dhe se sukcesi i saj varet nga vetë ata. Menaxherët çdoherë përballen me sfida të ndryshme, gjithë jeta e tyre kalon duke mësuar gjëra të reja qoftë nga sukcesi apo dështimi i tyre. Si konkludim mund të themi se planifikimi ishte funksioni më i rëndësishëm i menaxhmentit dhe se përmes tij varej sukcesi organizativ. Planerët duhet të studionin dhe analizonin çdo gjë detajisht. Së pari të bëjnë parashikimin e çdo mundësie të mundshme, të caktojnë qëllimet e tyre, të bëjnë zgjedhjen e alternativës më të mirë dhe të formulojnë planet të cilat kanë korrelacion me buxhetet e tyre që së fundi të kenë një planifikim të mirëfilltë dhe të qëndrueshëm.

Kuptuam se gjatë planifikimit ka edhe rreziqe të ndryshme që ndonjëherë nëse anashkalohen dhe nuk studiohen atëherë nga një rrezik sa do i vogël shumë lehtë mund të vije falimentimi, kjo tregon se vendimet menaxheriale nuk duhen të merren përmes intuitës. Menaxherët që të bëjnë planifikimin e duhur domosdoshmërisht duhej të analizonin faktorët e mikromjedisit dhe të makromjedisit, pra çdo gjë që ka të bëjë me organizatën direkt dhe indirekt.

Ekzistonin dhe analiza të ndryshme që duheshin të merreshin për bazë dhe se në rast nevojë mund të merreshin dhe mendime të ekspertëve të ndryshëm. E pamë se menaxherët gjenden në pozicionet e tyre në hierarki dhe se varësisht nga pozicioni ata kishin përgjegjësitë e tyre. Fati i organizatës kryesisht varej nga nivelet e larta hierarkike pasi që ato merreshin me planet afatgjata.

LITERATURA

- Decenzo, R., (2013) “Fundamentals of Management” 2013.
Horvat. D., Tintor, Z., (2012) “Ndërmarrësia”, Kolegji Universitar VICTORY, Prishtinë
Papa, M., Daniels, J., & Spiker, B., (2012) “Organizational Communication”, Sage, Losangelos USA
Ramosaj. B., (2007) “Management, Bazat e menaxhimit”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
Robo. M., & Xhvara. A., (2015) “Bazat e Sipërmarrjes”, Tiranë

³³ Horvat. D dhe Tintor. Z, “Ndërmarrësia”, Kolegji Universitar VICTORY, Prishtinë, 2008

³⁴ Decenzo R. “Fundamentals of Management”.